



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.11.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Kalendari i komisionit për shqyrtimin e buxhetit 2020.

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Klotilda Bushka, Ardiana Jaku, Amra Barova, Majlinda Halilaj, Eugen Bojaxhiu, Koçi Tahiri, Edmond Stojku, Ervis Meço, Halil Jakimi, Florenc Spaho dhe Roland Xhelilaj.

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi - ... (Mungesë incizimi) ...e këtyre të ardhurave. Bazuar në pikën 2 të nenit 82 të Kushtetutës përcaktohet se asnjë projektligj joqeveritar, që bën të mundur rritjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit ose pakësimin e të ardhurave, nuk mund të miratohet pa marrë mendimin e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga marrja e datës së projektligjit. Ky amendim do të shërbejë si bazë për vijimin e punës së komisionit për shqyrtimin e këtyre amendamenteve. Kjo është letra që i bëmë Këshillit të Ministrave për të shprehur amendimet e projektligjit të propozuar nga deputeti Ilir Beqaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të shprehet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kemi ende përgjigje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jeni dakord?

Kjo quhet e mirëqenë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni gjë për të shtuar për jodin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të kthehet në ministri?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Doktor Iliri, keni informacion për projektligjin për jodin?

Ilir Pendavinji – Ky projektligj u shqyrtua në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese. Atje u diskutua pjesa e mbetur, sepse ligji trajtonte vetëm pjesën që vjen nga importi, ndërkohë që pjesa më e madhe e kripës së prodhuar dhe përdorur në Shqipëri vjen nga prodhimi vendas. Flitej për afërsisht 10% të sasisë që rregullonte ky ligj, kurse 90%-shi nuk përmendej dhe nuk trajtohej në këtë ligj. Ndërkohë, u pa se duhet të merreshin me 90%-shin, sepse ishte shumë i rëndësishëm për përdorimin. I kërkua ministrisë të japë mendim për këtë pjesë dhe presim përgjigje.

Person – Atëherë, do të rishikohet komplet ligji nga e para?

Persone – Do të vijë një ligj i ri.

Person – Kjo që u bë deri tani nuk ...

Persone – Po, sepse ne u morëm me kripën ...

(Mungesë incizimi)

Doktor Iliri e shpjegoi dhe mendova se nuk ishte e nevojshme. Megjithatë, me sa kuptova unë, në ligj flitej për kripën e importuar në Shqipëri, që, sidoqoftë, është një sasi shumë e vogël, ndërkohë që sasia më e madhe që prodhohet në vend nuk kishte mekanizma kontrolli në ligj. Si do të kontrollohet që është apo jo e jodizuar? Ministrisë i është kërkuar ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di si është puna? Ne e diskutuam gjatë kur bëmë mbledhjen e përbashkët me Komisionin e Veprimtarive Prodhuese. Pjesën më të madhe të kohës së mbledhjes së të dyja komisioneve e mori vendimi nëse do ta vendosnim apo jo detyrimin për të kontrolluar kripën

për çdo ngarkesë, për të bërë analizën e jodit, por ligji nuk parashikonte kontroll të ngarkesave që dilnin nga subjekti, që prodhon kripën në Shqipëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e rregullon.

Në cilën mënyrë do të bëhet kontrolli?

Ministria duhet të gjejë mënyrën. Kështu u tha.

Faleminderit!

Person – Prodhimi vendas nuk ka vetëm kripë të jodizuar, por edhe kripë jo të jodizuar për qëllime industriale. Mendoj se duhet ndarë.

Persone – Duhet rishikuar ligji.

Enver Roshi – Kriporja e Vlorës, që është prodhuesja kryesore, nuk e ka detyrim ligjor të prodhojë kripë të jodizuar. Licenca e saj është të prodhojë kripë masive, qoftë industriale, apo për përdorim ushqimor, por jo të jodizuar. Pyetja me është: ky ligj do ta detyrojë të prodhojë kripë të jonizuar të ngrejë impiantin e pasurimit, apo do t'ia shesë dikujt tjetër? Më saktë, çdo prodhues i kripës do t'ia japë dikujt tjetër? Do të ngrihet një qendër tjetër për fortifikimin e kripës?

Jemi në pritje për të gjitha përgjigjet.

Kalojmë në rendin e ditës për të bërë kalendarin e ardhshëm për shqyrtimin e buxhetit. Kemi disa mbledhje. Kemi një shqyrtim në parim me Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Kemi një shqyrtim në parim me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave.

Kemi seancë dëgjimore për çështjet e shëndetësisë, seancë dëgjimore për çështjet sociale dhe shqyrtimin nen për nen.

Këto janë planifikuar për datat që keni në krahun e djathtë.

E konfirmuam, ditën e hënë, më 18 nëntor, në orën 11:00 me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ditën e premte, më 15 nëntor, në orën 11:00, kemi shqyrtimin në parim me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Renditja ishte e tillë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Axhenda është e zënë dhe duhet të përgjigjemi.

Më pas kemi seancë dëgjimore për çështjet e shëndetësisë. Kur do ta vendosim?

(Diskutime pa mikrofon)

Për të gjitha pikat e buxhetit.

(Diskutime pa mikrofon)

Pas datës 18. Nuk ka lidhje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet të mbyllen brenda një afati kohor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vendosim datën 19 për dëgjuesë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të lëmë orën 11:00 sërish?

Eglantina Jera – Orën 10:00.

Enver Roshi – Dakord.

Dëgjuesën tjetër e lëmë në datën 21.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka seancë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta lëmë në datën 20, apo 21?

(Diskutime pa mikrofon)

Sekretaria sugjeron të lëmë datat 20 dhe 21 për seancat dëgjimore. Data 19 do të jetë bosh për të shprehur mendimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vendosim datat 20 dhe 21.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më pas kemi shqyrtimin nen për nen për ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eglantina Jera – Dorëzimi i raportit është në datën 9 dhjetor. Para datës 9 dhjetor duhet të bëjmë shqyrtimin nen për nen.

Enver Roshi – 4 ditë para datës 9 dhjetor.

(Diskutime pa mikrofon)

Ka mundësi ta vendosim ditën e enjte.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kalimin nen për nen do ta vendosim më 4 dhjetor.

(Diskutime pa mikrofon)

Kemi një kërkesë, të cilën e presim edhe në rrugë protokollare. Meqenëse është java e antibiotikëve, ata kanë kërkuar një seancë dëgjimore me Komisionin e Shëndetësisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këta të fakultetit, OBSH-ja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për antibiotikët.

-Eglantina Jera- Jemi te buxheti.

Enver Roshi – Buxheti mbaroi.

Persone – Jo, nuk mbaroi.

Enver Roshi – Pse?

Eglantina Jera – Kemi dy seanca dëgjimore për buxhetin.

Unë kam bërë një draft. Ju mund të shprehni dakordësinë tuaj.

Klodi nuk është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi - Kjo është për çështjet sociale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkë.

Eglantina Jera – Ka një kërkesë me shkrim nga grupi i romëve dhe egjiptianëve, të cilët kanë shprehur interes.

Të tjerët janë të ftuar, përderisa përfaqësojnë grupe të mëdha, si Konfederata, Bashkimi i Sindikatave, Këshilli Kombëtar, Shoqata e Invalidëve, Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara, Shoqata e të Verbërve, Organizata për Mbrojtjen e Grave dhe të Fëmijëve e të tjerë me radhë.

Enver Roshi – ISHP-ja pse nuk është?

Eglantina Jera - Janë institucione shtetërore.

Enver Roshi – Universiteti i Mjekësisë është.

Eglantina Jera – Universiteti i Mjekësisë ka buxhetin e vet.

Enver Roshi – Dakord.

Keni ndonjë gjë për të ftuarit?

(Diskutime pa mikrofon)

Person - Jemi shumë të barabartë të gjithë. Çfarë halli ke ti?

(Diskutime pa mikrofon)

Enver Roshi – Jeni dakord për listën?

Eglantina Jera – Ne do t’ia dërgojmë me *e-mail*. Më pas do të flasim për opinionet, për buxhetin dhe më pas, se kush do të marrë pjesë, do të ...

Në çdo *e-mail* do të vendosim ...

Enver Roshi – Dakord.

Adelina Rista - Me datat që kemi para, periudha për shqyrtimin e projektbuxhetit do të jetë shumë e ngarkuar.

Unë do të doja që ju, si kryesi e komisionit, të jeni në kontakt me komisionet e tjera, për të mos pasur përplasje oraresh, sepse ndodh që në të njëjtin orar duhet të jemi edhe këtu, edhe te komisioni tjetër. Nuk mund t'i anashkalojmë, sepse është shumë e rëndësishme pjesëmarrja edhe këtu, edhe në një komision tjetër. Të mos ketë përplasje oraresh.

Nga ana tjetër, për ne që jemi nga rrethet, diskutimi i projektligjit dihet që është periudha më e ngjeshur. Nëse ne vijmë paradite dhe bëjmë një seancë dëgjimore me një grup interesi, është mirë të bëjmë seanca radhë, edhe pasdite, me një pushim në drekë, sepse kështu kemi bërë edhe vitet e tjera. Ne mund të bëjmë edhe seanca të tjera, që të mos vijmë për të dëgjuar vetëm një grup interesi, por t'i listojmë me orare njëri pas tjetrit.

Enver Roshi – Dakord.

Eglantina Jera – Për sa u përket shqyrtimeve në parim, nuk ndryshojmë gjë, sepse u lidhëm direkt, do ta prezantojë ministri.

Eglantina Jera – Ato me ministrat po, por flas për grupet e interesit.

Eglantina Jera – Për grupet e interesit, meqenëse janë shumë, mendimi im ishte t'i ndajmë në dy pjesë: çështjet sociale dhe shëndetësinë. Ju, nëse doni..

Enver Roshi – Jo, të jenë veç e veç.

Kemi data të lira?

Eglantina Jera – Për mendimin tim, në periudhën e buxhetit nuk mund të vendosim aktivitete të tjera, sepse është shumë e ngjeshur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi - Është javë e ngjeshur.

Eglantina Jera – Ka ardhur vetëm kalendari për buxhetin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi – Në dhjetor.

(Diskutime pa mikrofon)

E kemi në dhjetor.

Kjo është e datës 15 nëntor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për antibiotikun do të fillojmë në datën 18 deri më 22. Nëse doni, në datën 19 të lëmë një orë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E lëmë në parim në datën 19 për seancë dëgjimore për antibiotikët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për diabetin do ta diskutojmë në dhjetor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, do të vijnë nga Fakulteti i Mjekësisë, nga Fakulteti i Farmacisë, nga ISHP-ja dhe

...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbyllim.

MBYLLET MBLEDHJA